



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
AGJENCIA E INDUSTRIË SË MBROJTJES

Nr. 427 prot.

Tiranë, më 24.07.2026

URDHËR

Nr. 149 datë 24.07.2026

PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR CILËSINË, TESTIMIN DHE CERTIFIKIMIN E
PRODUKTEVE TË INDUSTRIË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 6, shkronjat "a" të VKM-së nr. 794, datë 19.12.2024, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes" dhe nenit 6, pika 3, shkronja "a" të Rregullores së Brendshme të Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes, miratuar me Urdhrin nr. 2514, datë 02.12.2025, të Ministrit të Mbrojtjes me qëllim miratimin e rregullave për cilësinë, testimin dhe certifikimin e produkteve të Industrisë së Mbrojtjes,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullave për cilësinë, testimin dhe certifikimin e produkteve të Industrisë së Mbrojtjes, dhe lidhjes përkatëse, sipas teksit që i bashkëlidhet këtij urdhëri dhe është pjesë e pandarë e tij.
2. Me këto rregulla njihet i gjithë personeli i Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes dhe subjektet e licencuara.
3. Ndjek zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, Drejtoria e Ekspertizës Teknike, Drejtoria e Analizës, Planifikimit dhe Bashkëpunimit, Drejtoria e Inspektimit dhe Standarteve si dhe Drejtoria e Vlerësimit të Lehtësirave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR PËRGJITHSHËM

Dorian TOLA



Adresa: Rruga e "Dibrës", Tiranë, Kutia Postare 2423

Telefon/centrali: (04)2226601

Faqe 1 nga 1



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBOJTJES
AGJENCIA E INDUSTRIË SË MBROJTJES**

**RREGULLAT PËR CILËSINË, TESTIMIN DHE CERTIFIKIMIN
E PRODUKTEVE TË INDUSTRIË SË MBROJTJES**

MIRATUAR ME URDHRIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

NR. 149 DATE 24.07.2026

PËRMBAJTJA

I. HYRJE.....	3
II. KORNIZA LIGJORE	3
III. PARIMET THEMELORE.....	3
IV. TERMINOLOGJIT DHE PËRKUFIZIME	4
4.1. Për qëllime të këtyre rregullave, termat e mëposhtëm kanë kuptimet si më poshtë:	4
V. KLASIFIKIMI I PRODUKTEVE DHE VLERËSIMI I RISKUT	5
5.1. Kategoritë e Produkteve:.....	5
5.1.1. Kriteret e Vlerësimit të Riskut: Modeli i Vendimarrjes me Shumë Kritere (MCDA).....	5
5.1.1.1. Nivelet e riskut dhe masat e rekomanduara:	6
VI. STANDARDET E APLIKUESHME AQAP DHE NATO	7
6.1. Sistemi i certifikimit mbështetet në hierarkinë e mëposhtme të standardeve:	7
6.1.1. Sqarime për standartet e NATO-s (STANAG dhe AQAP) si dhe ISO/TEC të kërkuara:.....	7
VII. PROCESI I CERTIFIKIMIT	9
7.1. Hapat e procesit të certifikimit:	9
7.1.1. Raste të vecanta:	10
7.1.1.1. Dokumentacioni i kërkuar:	10
7.1.1.2. Rrjedha e procesit të certifikimit, nga paraqitja e plotë e dosjes tekniko-ligjore deri në njohjen e skemës së certifikimit.....	11
VIII. TESTIMI TEKNIK.....	12
8.1. Parimi i testimit të pavarur:.....	12
8.1.1. Llojet e testimeve:	12
IX. DISPOZITAT KALIMTARE	12
X. RISHIKIMI DHE PËRDITËSIMI	12
ANEKSI A – Partnerët ndërkombëtarë:.....	13

<i>Tabela 1: Terminologjia e përdorur dhe përkufizime bazë</i>	<i>4</i>
<i>Tabela 2: Kategoria e produkteve ushtarake</i>	<i>5</i>
<i>Tabela 3: Faktorët e vlerësimit për analizën e riskut me shumë kritere.....</i>	<i>6</i>
<i>Tabela 4: Nivelet e riskut dhe masat e rekomanduara</i>	<i>6</i>
<i>Tabela 5: Standardet e aplikuarra</i>	<i>7</i>
<i>Tabela 6: Hapat e certifikimit</i>	<i>9</i>
<i>Tabela 7: Llojet e testimit sipas kategorisë dhe nivelit të riskut</i>	<i>12</i>
<i>Tabela 8: Lista e partnerëve ndërkombëtarë.....</i>	<i>13</i>
<i>Tabela 9: Kriteret e vlerësimit, interpretimi dhe pesha e tyre</i>	<i>13</i>

I. HYRJE

Këto rregulla, janë përgatitur me qëllim përcaktimin e kërkesave për sigurinë, cilësinë, testimin, certifikimin dhe vlefshmërinë e dokumentacionit teknik të proceseve dhe produkteve në industrinë e mbrojtjes, përpara se ato të hyjnë në treg. Ato përfshijnë udhëzime duke filluar nga hapat/veprimet dhe kërkesat minimale që duhet të plotësojë operatorët ekonomikë në kuadër të procedurave të licencimit në veprimtaritë e prodhimit, montimit dhe riparimit, të mallrave ushtarakë pjesë e industrisë e mbrojtjes. Rregullat synojnë harmonizimin e kriterëve teknike të produkteve dhe proceseve në industrinë e mbrojtjes me standardet ndërkombëtare, NATO-s dhe BE për garantimin e cilësisë së mallrave ushtarakë të prodhuar në Shqipëri.

Këto rregulla janë të aplikueshme për të gjithë operatorët ekonomikë që kërkojnë të licencohen, apo janë të licencuar në fushën e prodhimit, montimit dhe riparimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu këto rregulla zbatohet për institucionet, laboratorët dhe subjektet që kryejnë testime teknike dhe certifikime për produktet, të cilat prodhohen nga industria e mbrojtjes vendase.

II. KORNIZA LIGJORE

Rregullat janë hartuar në zbatim të pikës c, nenit 11 të Ligjit Nr. 87/2024, *“Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”* dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 794, datë 19.12.2024 *“Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes”*, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 793, datë 19.12.2024 *“Për licencat dhe autorizimet e lëshuara nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes”*, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 569, datë 15.10.2025 *“Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe listës së artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare”* si dhe Urdhërit nr. 2514, datë 02.12.2025 të ministrit të Mbrojtjes, *“Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes””*,

III. PARIMET THEMELORE

Zbatimi i kësaj rregulloreje mbështetet në këto parime themelore detyruese:

Kontrollit të bazuar në risk: Kontrolli, testimi, certifikimi dhe mbikëqyrja e produkteve përcaktohen në përpjesëtim të drejtpërdrejtë me nivelin e riskut që përmban aktiviteti i prodhimit të mallrave ushtarak. Niveli i riskut vlerësohet sipas: natyrës dhe kategorisë së produktit; ndjeshmërisë teknologjike; ndikimit në sigurinë kombëtare dhe operacionale; historikut të konformitetit të operatorit. Matrica e detajuar e riskut dhe modeli i Analizës Shumë-Kriteriale e Vendimmarrjes (MCDA) është paraqitur në Aneksin B.

Mbikëqyrja gjatë ciklit jetësor: Mbikëqyrja ushtrohet gjatë gjithë ciklit jetësor të produktit: testim, prodhim, përpara vendosjes në treg, përdorim operacional, modifikim.

Provueshmëria: Cilësia e produkteve bazohet në prova të verifikueshme, gjurmueshme dhe të dokumentuara.

Provat përfshijnë: raporte testimi nga laboratorë publik, privat të akredituar ose laboratorë ushtarakë, raporte/relacione teknike të grupeve të punës të ministrisë së Mbrojtjes, ose Forcave të Armatosura, certifikata konformiteti, vetëdeklarimet e operatorëve dhe dokumentacion tjetër teknik të verifikueshëm.

Dokumentimi i plotë: Të gjitha proceset e testimit, vlerësimit dhe certifikimit dokumentohen plotësisht. Dokumentacioni ruhet sipas vlefshmërisë së licencës së operatorit dhe mbrohet nga ndërhyrje të pa autorizuar ose humbja. Të dhënat të jenë të aksesueshme për kontroll nga AIM dhe autoritetet kompetente.

Certifikimi i pavarur i mbikëqyrur: Certifikimi kryhet nga trupa certifikuese të akredituara dhe të pavarura nga operatori ekonomik.

Testimet e prodhuesit: Testimet e kryera nga vetë prodhuesi bëhen në përputhje me standardet aplikuar që rregullojnë këtë proces.

Testimet e pavarura: Testimet e pavarura kryhen nga qendra e testeve ose laboratore të akredituar.

IV. TERMINOLOGJIT DHE PËRKUFIZIME

4.1. Për qëllime të këtyre rregullave, termat e mëposhtëm kanë kuptimet si më poshtë

Tabela 1: Terminologjia e përdorur dhe përkufizime bazë

Termi	Përkufizimi
Mall ushtarak	Çdo pajisje, sistem, komponent, material, softuer ose shërbim teknik i destinuar, ose i përshtatur për përdorim ushtarak ose për qëllime të sigurisë kombëtare sipas përkufizimi të ligjit 87 /2024.
AQAP — Allied Quality Assurance Publication	Seri standardesh të cilësisë të NATO-s (2110, 2105, 2210, 2310, 2131) që rregullojnë sistemet e menaxhimit të cilësisë industriale për kontratat e mbrojtjes.
Certifikim	Procesi nëpërmjet të cilit vlerësohet nëse një mall ushtarak plotëson kërkesat e cilësisë sipas standardit të deklaruar, bazuar në testimet, vlerësimet dhe dokumentet vërtetuese të përcaktuara në skemën e certifikimit.
Skema e certifikimit	Udhërrëfyese që përcakton certifikatat, testimet dhe dokumentet e tjera vërtetuese që duhet të paraqesë aplikuesi për të garantuar përmbushjen e kërkesave të cilësisë sipas standardit të deklaruar.
Produkt i certifikuar	Produkt i certifikuar është malli ushtarak, i cili është prodhuar nëpërmjet proceseve të certifikuara sipas një sistemi të menaxhimit të cilësisë të njohur (ISO 9001, EN 9100, AQAP 2110), ka kaluar testimet teknike sipas standardeve të referencës, dhe shoqërohet me dokumentacion teknik e deklaratë konformiteti të vlefshme në përputhje me skemën e certifikimit.
Plani i cilësisë	Plani i cilësisë i hartuar nga operatori sipas AQAP 2105, që specifikon si do të zbatohen kërkesat e cilësisë gjatë kontratës ose zbatimit të projektit.
Trupa certifikuese	Grupë e pavarur e akredituar sipas ISO/IEC 17021-1 për auditimin dhe certifikimin e sistemeve të menaxhimit (ISO 9001, EN 9100).
Operator ekonomik	Subjekti aplikues, i cili kërkon të pajiset me licencën ose autorizimin përkatës për prodhimin, tregtimin, kërkimin dhe zhvillimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake.
Deklaratë konformiteti	Deklarata që vërteton se një produkt, shërbim, ose sistem plotëson standarde, specifikimet të veçanta, ose parakushtet rregullatore sipas formatit të harmonizuar EU/NATO
Deklaratë e pranimit	Deklarata e lëshuar nga porositësi i mallit ushtarak që vërteton se produkti është në përputhje me standardet e kërkuara në kontratë.
MCDA	Model i Vendimarrjes me Shumë Krite

Weighted Sum Model (WSM)

Agregimi aditiv – Metoda e Shumës së Ponderuar

Weighted Product Model (WPM)

Agregimi multiplikativ – Metoda e Produktit të Ponderuar

V. KLASIFIKIMI I PRODUKTEVE DHE VLERËSIMI I RISKUT**5.1. Kategoritë e Produkteve:**

Produktet e industrisë së mbrojtjes klasifikohen në kategori teknike në bazë të karakteristikave funksionale, nivelit të kompleksitetit teknologjik dhe rolit operacional, duke mundur një strukturim të standardizuar për qëllime vlerësimi, certifikimi dhe menaxhimi të riskut.

Produktet e industrisë së mbrojtjes klasifikohen sipas kategorive teknike të mëposhtme:

Tabela 2: Kategoria e produkteve ushtarake

Kat.	Kategoria	Produktet	Risku bazë
A.	Armë, municion dhe eksplozive	Fishekë, predha, eksplozivë, armë zjarri, sisteme artilerie, raketore, lëndë ndezëse	I LARTË
B.	Mjete dhe sisteme ajrore	Avion, Helikopter, Dronë zbulimi dhe luftarakë, sistemet e kontrollit, avionikë, sisteme autonome	I LARTË
C.	Mjete dhe sisteme detare	Anije, Mjete detare pa pilot, sistemet e kontrollit, mjete nënujore pa pilot etj.	I LARTË
D.	Mjete ushtarake	Automjete taktike dhe të blinduara, mjete logjistike, mjete të specializuara inxhinierike	I MESËM
E.	Pajisje mbrojtëse individuale	Jelekë balistikë, helmeta, uniforma taktike, PMI ushtarake, etj.	I MESËM
F.	Sisteme elektronike dhe komunikimi	Sensorë, radarë, sisteme komunikimi, ECM/ECCM, sisteme navigacioni	I LARTË
G.	Softwer ushtarak	Sisteme komandë-kontrolli, softwer operativ kritik, sisteme autonome, IA ushtarake	I LARTË
H.	Komponentë dhe materiale speciale	Materiale, lëndë të para, komponentë që shërbejnë për prodhimin ushtarakë të cilët nuk bëjnë pjesë më lart	I ULËT

5.1.1. Kriteret e Vlerësimit të Riskut:**Modeli i Vendimarrjes me Shumë Kritere (MCDA)**

Produktet vlerësohen dhe klasifikohen në bazë të pesë kritereve kryesore, ku secili kriter vlerësohet me një shkallë diskrete nga 1 deri në 3, që përfaqëson nivele të ndryshme të intensitetit të riskut ose rëndësisë (1 - i ulët, 2- i mesëm dhe 3 - i lartë).

Tabela 3: Faktorët e vlerësimit për analizën e riskut me shumë kriterë

Kriteri	Pikë 1 — I ulët	Pikë 2 — I mesëm	Pikë 3 — I lartë
(K1) Vlerësimi operacional	Komponent dytësor; pa ndikim thelbësor në mision	Pajisje operative; ndikim i kufizuar	Sistem kritik; ndikim i drejtpërdrejtë në mision
(K2) Kompleksiteti teknik	Teknologji e zakonshme, pa integrim kompleks	Teknologji e moderuar; integrim i kufizuar	Teknologji e avancuar; integrim sistem-sistem
(K3) Ndikimi strategjik	Pa ndikim strategjik; disponueshëm në treg	Teknologji me kontroll; dual-use (me funksion të dyfishtë)	Ndikim strategjik i lartë; potencial keqpërdorimi
(K4) Risku i zinxhirit të furnizimit	Furnitorë të verifikuar; asnjë varësi kritike	Varësi e moderuar; furnitorë kryesisht të verifikuar	Varësi e lartë; furnitorë me rrezik ose jo-verifikuar
(K5) Historiku i operatorit	Historik i shkëlqyer; pa asnjë problematikë,	Historik i mirë; problematika të vogla,	Historik i dobët; problematika të rënda,
	Zotëron ekperiencë	Eksperiencë modeste	Pa eksperience relevante

5.1.1.1.Nivelet e riskut dhe masat e rekomanduara:

Totali i pikëve, i llogaritur si shuma e vlerësimeve të pesë kriterëve (K1+K2+K3+K4+K5) përdoret për të përcaktuar nivelin e përgjithshëm të riskut dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë, kërkesat përkatëse të certifikimit të produktit, si më poshtë:

Shenim: Për K5 merret mesatarja aritmetike e vlerësimeve.

Tabela 4: Nivelet e riskut dhe masat e rekomanduara

Pikë	Niveli	Shembuj	Kërkesat e certifikimit
5–7	I ULËT	Komponentë mbrojtjeje, materiale jo-kritike, PMI e thjeshtë	ISO 9001 (CB i akredituar); dokumentacion teknik i plotë, testimet e funksionalitet bazë, testime sipas standardit të deklaruar të prodhuesit.
8–11	I MESËM	Mjete ushtarake, jelekë balistikë, pajisje (PMI) komplekse	Përvec kërkesave të mësipërme, Plan i cilësisë (sipas AQAP 2105 në rastet kur kërkohet në kontrate); testime specifike sipas produktit referuar tabelës nr.8, testime sipas standardit të deklaruar të prodhuesit, testime të porositesit të mallit nëse disponohen, deklaratë e pranimi nga porositesi të mallit me të njëjtat specifitime nga një kontratë e mëparshme.
12–15	I LARTË	Armë, municione, dronë, softwer kritik, sisteme elektronike	Përvec kërkesave të niveleve më të ulëta: sistem i certifikuar sipas AQAP 2110/2210/2310 sipas natyrës së kontratës, testime të kualifikimit, sigurisë, performancës dhe besueshmërisë sipas STANAG,MIL-STD dhe standardeve ndërkombëtare relevante, kontrole të sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së informacionit (ISO 27001/IEC 62443 kur aplikohet), kontroll i ndryshimeve teknike. Testime nga palë te treta te pavarur.

Klasifikimi i riskut rishikohet menjëherë në rastet kur: (a) ndodh incident sigurie; (b) ndryshon konfigurimi teknik i produktit; (c) ndryshon furnitori kritik; (d) konstatohet jo-konformitet i rëndë gjatë inspektimit dhe (e) Të tjera sipas kontekstit të procesit/problematikës

VI. STANDARDET E APLIKUESHME AQAP DHE NATO

6.1. Sistemi i certifikimit mbështetet në hierarkinë e mëposhtme të standardeve:

Tabela 5: Standardet e aplikuara¹

Niv.	Standardi	Funksioni	Kur aplikohet
N1	AQAP 2110:2016	QMS — Projektim, zhvillim, prodhim	Të gjitha kontratat me komponent prodhim (Cat. A–G, risk i mesëm–i lartë).
L1	AQAP 2105:2014	Quality Plan — shoqëron AQAP 2110	Bashkë me AQAP 2110
L1+	AQAP 2210:2015	Shtesë softuerësh kritikë	Kur prodhim përfshijnë zhvillim ose integrim softuerësh (Cat. F ose sisteme E/F të integruara).
L2	AQAP 2310:2014	Sisteme armësh komplekse	Sisteme avionike, raketore, sisteme të integruara të nivelit të lartë.
L2	AQAP 2131:2014	Testimi i nënkontraktuar	Kur testimi delegohet tek nënkontraktorë ose laboratorë të jashtëm.
Gov	STANAG 4107 / AQAP 2070	Mekanizëm ndërqeveritar GQA	NUK futet në kontratat me furnitorin.
SMC	ISO 9001:2015	Certifikim QMS bazë	Kërkesë minimale për të gjithë operatorët. Certifikohet nga CB i akredituar.
QMS+	EN 9100:2018	QMS aerospace/defence	I detyrueshëm për Cat. A, B, E, F ose kur klient ndërkombëtar kërkon EN 9100.
Lab	ISO/IEC 17025:2017	Kompetenca laboratorike	I detyrueshëm për të gjithë laboratorët e njohur nga AIM.
	IATG	Standardet e OKB	Udhëzimet Ndërkombëtare Teknike për municionet

6.1.1. Sqarime për standartet e NATO-s (STANAG dhe AQAP) si dhe ISO/IEC të kërkuara:

Tabela 6: Standardet teknike të përdorura në përputhje me kërkesat e NATO-s

¹ Linku për aksesimin e standarteve publike të NATO:

<https://nso.nato.int/nso/nsdd/main/list-promulg>

AQAP 2110	Kërkesat e NATO-s për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë e furnitorëve të angazhuar në projektim, zhvillim dhe prodhim. Standardi kryesor kontraktor i cilësisë - i detyrueshëm për operatorët në kontratat e mbrojtjes.
AQAP 2105	Kërkesat e NATO-s për Planin e Cilësisë (PC) - shoqëron çdo kontratë ku kërkohet AQAP 2110/2210.
AQAP 2210	Shtesa e NATO-s për softuer - e detyrueshme kur kontratat përfshijnë zhvillim ose integrim softuerësh kritikë.
AQAP 2310	Kërkesat e NATO-s për sistemet e armëve komplekse - zbatohet për sisteme avionike, raketore dhe sisteme të integruara.
ISO/IEC 17025	Standardi ndërkombëtar që përcakton kërkesat e përgjithshme për kompetencën, paanshmërinë dhe funksionimin e qëndrueshëm të laboratorëve të testimit dhe kalibrimit. Garanton se rezultatet e testimit janë teknikisht të sakta, të riprodhueshme dhe ndërkombëtarisht të pranueshme.
ISO/IEC 17020 – Trupa Inspektimi	Standardi ndërkombëtar që specifikon kërkesat për funksionimin e trupave të inspektimit të pavarur, duke garantuar paanshmërinë, kompetencën teknike dhe qëndrueshmërinë e rezultateve të inspektimit. Zbatohet për trupat që kryejnë inspektim të pajisjeve, mjeteve, instalimeve dhe sistemeve ushtarake, dhe lëshojnë raporte ose certifikata inspektimi.
ISO/IEC 17043 – Ofrues të Testimit të Aftësisë	Standardi ndërkombëtar për ofruesit e testimit të aftësisë (Proficiency Testing - PT) dhe krahasimeve ndërlaboratorike (ILC). Garanton vlefshmërinë dhe krahasueshmërinë e rezultateve të testimit mes laboratorëve të ndryshëm, duke siguruar se laboratorët e njohur nga AIM prodhojnë rezultate të besueshme dhe të verifikueshme.
ISO/IEC 17029 – Trupa të Validimit dhe Verifikimit	Standardi ndërkombëtar që përcakton parimet dhe kërkesat e përgjithshme për trupat e validimit dhe verifikimit. Aplikohet për deklaratat dhe pohimet e verifikueshme mbi produktet, proceset dhe sistemet e industrisë së mbrojtjes, duke siguruar saktësinë e të dhënave dhe deklaratave të paraqitura nga operatorët ekonomikë.
ISO/IEC 17021 – Certifikimi i Sistemeve të Menaxhimit	Standardi ndërkombëtar që specifikon kërkesat për trupat që auditojnë dhe certifikojnë sistemet e menaxhimit (si ISO 9001, EN 9100, ISO 14001, ISO 45001). Trupat certifikuese (CB) të njohura nga AIM duhet të jenë të akredituara sipas këtij standardi, i cili garanton pavarësinë, kompetencën dhe qëndrueshmërinë e procesit të certifikimit.
ISO/IEC 17065 – Trupa të Certifikimit të Produkteve	Standardi ndërkombëtar për trupat e certifikimit të produkteve, proceseve dhe shërbimeve. Specifikon kërkesat për paanshmërinë, kompetencën dhe vazhdimësinë e proceseve të certifikimit të produktit. Zbatohet kur certifikohet vetë produkti (jo sistemi i menaxhimit), duke garantuar se produkti i certifikuar plotëson kërkesat e specifikuara teknike.

MCDA - Analiza Shumë-Kriteriale e Vendimmarrjes

Metodologji që përdoret për të vlerësuar dhe renditur rreziqet bazuar në shumë kritere (p.sh. probabiliteti, ndikimi, ekspozimi), duke mundësuar një analizë të strukturuar, të krahasueshme dhe transparente për prioritizimin e ndërhyrjeve. MCDA shërben për të krijuar një indeks të përbërë të riskut.

STANAG 4107

Mekanizmi ndërqeveritar i NATO-s për njohjen reciproke të GQA-së mes vendeve aleate. Rregullon delegimin e funksionit GQA tek një autoritet homolog. Nuk futet direkt në kontratat me furnitorin.

VII. PROCESI I CERTIFIKIMIT

7.1. Hapat e procesit të certifikimit:

Procesi i certifikimit ndahet në shtatë hapa të njëpasnjëshëm me kontroll formal në çdo hap/etapë:

Tabela 6: Hapat e certifikimit

Hapa	Emërtimi	Veprimet	Rezultati
H-1	Aplikimi	Operatori paraqet aplikimin për licencë paraprake për zhvillimin e veprimtarisë së prodhimit së bashku me dokumentet e kërkuara sipas VKM, Nr. 793, date 19.12.2024 “Për Licencat dhe Autorizimet e Lëshuara nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes”	Aplikimi për licencë
H-2	Klasifikimi i riskut	AIM klasifikon produktin sipas kriterëve të vlerësimit, vlerëson nivelin e riskut dhe kërkesat e aplikueshme të testimit dhe përcakton skemën e certifikimit.	AIM informon aplikantin për skemën e certifikimit. Operatori ekonomik pasi pajiset me licencë paraprake ka afat 2 vjet deri në aplikimin për licencë prodhimi që të plotësojë dosjen teknike të skemës së certifikimit.
H-3	Operatori ekonomik aplikon për licencë për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit	Operatori ekonomik përpara, ose në kohën e aplikimit për licencë për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit duhet të ketë plotësuar dosjen teknike të skemës së certifikimit.	AIM pranon aplikimin për licencë për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit
H-4	Vlerësimi teknik nga AIM	AIM vlerëson dokumentacionin sipas aplikimit.	AIM pas vlerësimit të aplikimit lëshon ose refuzon licencën kryerjen e veprimtarisë së prodhimit

7.1.1. Raste të vecanta:

1. Kur një institucion sigurie në Shqipëri apo në një shtet tjetër, pranon marrjen e një malli ushtarak nëpërmjet një deklarate pranimi, ky mall konsiderohet se i plotëson kërkesat e cilësisë për qëllime licencimi, edhe nëse nuk ka kaluar ende procesin e certifikimit të përmendur më sipër. Malli ushtarak mund t'i nënshtrohet procesit të certifikimit në rast se, gjatë përdorimit të tij, vërehen problematika që lidhen me cilësinë.

7.1.1.1. Dokumentacioni i kërkuar:

Çdo aplikim duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm, sipas kategorive përkatëse, në rastet kur ato aplikohen:

A. Sistemi i menaxhimit të cilësisë (QMS):

- a) Certifikim ISO 9001:2015 i vlefshëm, i lëshuar nga një organ certifikues i akredituar (CB);
- b) EN 9100:2018 në mënyrë proporcionale me nivelin e riskut;
- c) Plani i Cilësisë (Quality Plan), në përputhje me kërkesat e AQAP 2105, është i detyrueshëm për kontratat ushtarake sipas standardeve të NATO-s;

B. Dokumentacioni teknik i produktit:


- a) Analiza e sigurisë dhe e riskut : sipas metodave të njohura ndërkombëtarisht (HAZID, FMEA, MIL-STD-882E ose ekuivalente) dhe në përputhje me ISO 31000:2018.

C. Dokumentacioni i testimit:

- a) Raportet e testimit nga laboratorë publik, privat të akredituar, ose laboratorë ushtarakë;
- b) Deklaratë e konformitetit të lëshuar nga operatori.
- c) Relacione teknike, apo raporte testimi nga Grupet e Punës teknike të ministrisë së Mbrojtjes, Forcave të Armatosura, apo Grupeve ndërministrorë.
- d) Deklaratë pranimi nga porositësi në zbatim të një kontrate të mëparshme për të njëjtin lloj malli.

KUJDES: *Procesi konsiderohet i përmbushur kur Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes verifikon përmbushjen e kërkesave nëpërmjet vlerësimit të plotë të dokumentacionit të paraqitur në dosjen tekniko-ligjore, në përputhje me skemën e certifikimit. Gjithashtu, procesi konsiderohet i përmbushur edhe në rastet kur paraqitet një certifikatë produkti e lëshuar nga një organ/trup i/e pavarur i/e akredituar.*

7.1.1.2. Rrjedha e procesit të certifikimit, nga paraqitja e plotë e dosjes tekniko-ligjore deri në njohjen e skemës së certifikimit



VIII. TESTIMI TEKNIK.

8.1. Parimi i testimit të pavarur:

Të gjitha testimet teknike kryhen nga laboratorë publik, privat të akredituar ose laboratorë ushtarakë nga operatori ekonomik.

AIM mban Regjistrin e laboratorëve të njohur, i cili përditësohet çdo 6 muaj.

8.1.1. Llojet e testimeve:

Testimet kryhen në përputhje me kategorinë dhe nivelin e riskut të produktit, siç përcaktohet nga klasifikimi teknik dhe kërkesat përkatëse të certifikimit:

Tabela 7: Llojet e testimit sipas kategorisë dhe nivelit të riskut

Lloji i testimit	Kategoritë	Standarde e referencës
Testime funksionale	Të gjitha	Specifikimet teknike të produktit; standardet NATO përkatëse
Testime mjedisore	A, B, C, D, E, F,G,H	MIL-STD-810H (temperatura, lagështia, vibrimi, goditjet, presioni); DEF STAN 00-35
Testime balistike	A (municione), D (PPE)	NIJ Standard-0101.07; VPAM; EN 1063; STANAG 4569
Testime elektromagnetike (EMC/EMI)	E, F dhe sisteme integrate	MIL-STD-461G; DO-160G; EN 55032
Testime softuerësh	F dhe sisteme me softuer kritik	IEC 61508 (Functional Safety); DO-178C; MISRA C; AQAP 2210
Testime eksplozive	A (municione, eksplozivë)	NATO STANAG 4170; AOP-7; UN transport regulations
Testime mobilitetit	C (mjete ushtarake)	STANAG 4278; MIL-STD-1472 (ergonomi); standardet e homologimit

Shenim: AIM mund të kërkojë testime plotësuese në varësi të produktit.

Operatorët kanë të drejtë të paraqesin laboratorë të tjerë të akredituar. Laboratorët që nuk janë pjesë e kësaj liste mund t'i nënshtrohen një periudhe më të gjatë verifikimi.

IX. DISPOZITAT KALIMTARE

AIM bën njoftimin përkatës për skemën e certifikimit sipas kritereve që duhet të permbushen në funksion të licencës së prodhimit.

X. RISHIKIMI DHE PËRDITËSIMI

Këto rregulla rishikohen në rastet kur:

- ndodhin ndryshime të rëndësishme në standardet NATO ose BE;
- eksperienca përdoruesit evidenton nevojën për përmirësime;
- rekomandohet ndryshim nga një auditim ndërkombëtar, ose nga Ministria e Mbrojtjes

ANEKSI A – Partnerët ndërkombëtarë:

Tabela 8: Lista e partnerëve ndërkombëtarë

Autoriteti	Shteti	Fushat e bashkëpunimit
UK MOD / DE&S	UK	Model GQA, AQAP policy, trajnim GQAR, njohje reciproke
DGA (Direction Générale de l'Armement)	Francë	Procesi i Kualifikimit, testimi i municioneve, sisteme raketore
BAAINBW	Gjermani	Rrjeti WTD, AQAP implementation, GQA surveillance
NSPA (NATO Support and Procurement Agency)	NATO	Mbështetje në procesin e prokurimit, standardizim, kurs trajnimi AQAP
EDA (European Defence Agency)	BE	Kapacitete testimi, interoperabilitet (aftësi për ndërveprueshmëri), programet e certifikimit BE
TSSK Turk Savunma Sanayi Kurulu	Turqi	Një klaster (rrjet) i kompanive turke të mbrojtjes dhe teknologjisë që koordinon bashkëpunimin, inovacionin dhe zhvillimin e industrisë së mbrojtjes.
Jordan Desing Bureau	Jordani	JODDB është institucioni kryesor i Jordanisë për projektimin, zhvillimin dhe prodhimin e teknologjive dhe sistemeve të mbrojtjes, duke mbështetur njëkohësisht industrinë vendase dhe eksportet ushtarake.
VTSÚ Záhorie	Sllovaki	VTSÚ Záhorie është qendra kombëtare e Sllovakisë për kërkimin, zhvillimin, testimin dhe certifikimin e armëve, municioneve dhe teknologjive të mbrojtjes

Aplikimi i Modelit të Vendimarrjes me Shumë Kriteria (MCDA) në vlerësimin e riskut

Tabela 9: Kriteret e vlerësimit, interpretimi dhe pesha e tyre

K1	Rëndësia operacionale	Risk	Komponent dytësor; jo-operacional pa ndikim	$w_{k_1} -]0,25[$
K2	Kompleksiteti teknik	Risk	Teknologji e zakonshme; jo-integrim	$w_{k_2} -]0,20[$
K3	Ndikimi strategjik	Risk	Pa ndikim; produkt standard i disponueshëm në treg	$w_{k_3} -]0,20[$
K4	Risku furnizim	Risk	Furnitorë të verifikuar; pa varësi kritike	$w_{k_4} -]0,20[$
K5	Historiku i operatorit	Risk	Historik i shkëlqyer; zero jo-konformitete	$w_{k_5} -]0,15[$
Shuma				1.00

Për të siguruar që modeli i vlerësimit të jetë statistiki i saktë dhe i krahasueshëm ndërmjet rasteve të ndryshme, peshat e kritereve duhet të plotësojnë kushtin që shuma e tyre të jetë 1.

$$\sum_{j=1}^{n=5} w_j = 1 \quad 1$$

w_j - është pesha e paracaktuar për kriterin j .

n - është numri total i kritereve i barabartë me 5

Shënim: Peshat e kritereve përcaktohet dhe mund të rishikohet në varësi të kontekstit dhe karakteristikave të problemit në analizë.

Metoda 1: Aggregation - Weighted Sum Model (WSM) - Agregimi aditiv – Metoda e Shumës së Ponderuar

Për rastin me pesë kritere të vlerësimit të riskut, llogaritja kryhet në përputhje me formulën e paraqitur në ekuacionin (2).

$$S_i = \sum_{j=1}^{n=5} (w_j \cdot N_{ij}^{WSM}) \quad 2$$

S_i = Pikët finale të riskut për trupën i ; N_{ij} = Vlera e normalizuar

Për modelin me pesë kritere të vlerësimit të riskut, fillimisht kryhet normalizimi i secilit kriter, me qëllim që të sigurohet krahasueshmëria ndërmjet tyre. Më pas, rezultati përfundimtar llogaritet sipas metodës së shumës së ponderuar (WSM), si shuma e produkteve ndërmjet peshës përkatëse të secilit kriter dhe vlerës së tij të normalizuar. Në këtë rast nuk është përdorur normalizim i thjeshtë pasi vlerat janë diskrete dhe shmangim vlerën 0:

$$N_{ij} = \frac{4 - x_{ij}}{3} \quad 3$$

Vlerat e normalizuara variojnë nga 0.15 në 1.

Shënim: Modeli MCDA i zhvilluar në këtë material përfaqëson një kontribut origjinal të ekspertit të jashtëm, ndërsa e drejta e përdorimit të rezultateve dhe produkteve të zhvilluara i takon institucionit përfitues, në përputhje me marrëveshjen kontraktuale. Modeli mund të modifikohet sipas rastit (Shtohen apo hiqen kritere si dhe mund të ndryshohet pesha e kritereve, K1, K2, K3, K4 dhe K5).

Kriteret e vlerësimit të riskut duhet të shprehen në një shkallë diskrete nga 1 (risk i ulët) deri në 3 (risk i lartë). Për qëllime të analizës shumëkriteriale, këto vlera janë transformuar në një shkallë të normalizuar pozitive, duke shmangur vlerat zero dhe duke ruajtur renditjen relative të alternativave.

AQAP Allied Quality Assurance Publications	Publikim i Aleatëve për Sigurimin e Cilësisë	Publikim i Aleatëve për Sigurimin e Cilësisë Standardet e cilësisë të NATO-s për kontratat industriale. Seritë 2110, 2105, 2210, 2310, 2131.
MRA Mutual Recognition Agreement	Marrëveshje e Njohjes Reciproke Te plotësohen te gjitha sipas standardit mesiper	Marrëveshje bilaterale për njohjen e testimit dhe certifikimit ndërkombëtar.
QMS Quality Management System	Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë	Sistemi ISO 9001/EN 9100 i operatorit.
QP Quality Plan	Plani i Cilësisë	Dokument sipas AQAP 2105 për kontratën specifike.
SoA Statement of Acceptance	Deklarate Pranimit	Akti zyrtar i pranimit shtetëror nga FA.

CB Certification Body	Trup Certifikues	Body i akredituar ISO/IEC 17021-1 për QMS.
STANAG NATO Standardization Agreement	Marrëveshje e Standardizimit NATO	Standardizim ndërkombëtar i procedurave NATO; STANAG 4107 për GQA.
PPE Personal Protective Equipment	Pajisje Mbrojtëse Individuale	Jelekë, helmeta, uniforma mbrojtëse.
EMC/EMI Electromagnetic Compatibility / Electromagnetic Interference	Kompatibiliteti/Ndërhyrja Elektromagnetike	Testime elektromagnetike sipas MIL-STD-461.
Significant Technical Change	Ndryshim Teknik i Rëndësishëm	Ndryshim i konfigurimit, materialit ose procesit me ndikim potencial në konformitet.
NSPA NATO Support and Procurement Agency	Agjencia NATO për mbështetje dhe prokurimit	NSPA është agjencia e NATO-s që siguron prokurimin, logjistikën, mirëmbajtjen dhe mbështetjen teknike për forcat e vendeve aleate.

Hartuar nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes (AIM) — Korrik 2026